Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-27772/26
Kaçanik, 20.10.2026

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e IX (nëntë) të rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, për vitin 2026.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 28.10.2026 (e mërkurë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni
_____

Në mbledhjen e IX (nëntë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, të datës 28.10.2026, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

2. Raporti nëntëmujor financiar 2026, për periudhën 01.01.2026- 30.09.2026;

3. Propozim Vendim për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;

4. Propozim Vendim për Aprovim të Marrëveshjes për rikonstruktimin tërësor të objektit ish -"Shtëpia e mallrave", dhe transformimin e tij në Qendër Afariste-Banesore Moderne;

5. Plani Komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Kaçanikut.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/01-25454/26
Kaçanik, 29.09.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII (tetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2026 (Legjislatura e 8), mbajtur me 29.09.2026 (e martë), në katin e tretë, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.
Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendi i Komunës prej 21 anëtarëve, pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 20 anëtarë. Mungoi me arsye, Islam Gashi.
Nga Ekzekutivi i komunës morën pjesë: Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, 09 drejtor të drejtorive. Nga zyrtarët: Zyrtare e kuvendit dhe këshilltarja e kryetarit.
Nga OJQ ATRC morën pjesë 2 zyrtarë.

Nga MAPL, mbledhjen e monitoron zyrtari, Nehat Uka.
Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës: Makfire Malsiu-ZLPKK.

Kryesuesi i Kuvendit - Selajdin Troni: Së pari i përshëndeti të gjithë të pranishmit, iu dëshiroi mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur me emër, mungon Islam Gashi me arsye dhe gjithashtu desha të u lajmëroj se në d akordim me shefat e grupeve kemi vendosur që të përfshijmë edhe një pike: 1. Propozim- Deklaratë e cila ka të bëjë me Vendimin e marrë nga Gjykata Speciale në Hagë.

Në mbledhje marrin pjesë nga OJQ -ATRC. Fillimisht do të japim fjalën Qëndresa Hebibi nga kjo OJQ për qëllimin e pjesëmarrjes së tyre, pastaj vazhdojmë me pikat e rendit të punës.
znj. Qendresa Hebibi- nga OJQ- ATRC: Faleminderit Kryesues i Kuvendit për fjalën.
I nderuar Kryetar i Komunës,
i nderuar Nënkryetar,
të nderuar drejtorë të drejtorive,
të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës,
Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe për mundësinë që të jem sot këtu me ju.
Siç e dini, OJQ-ja ATRC, në kuadër të projektit "Monitorimi i Kuvendeve Komunale", ka filluar procesin e monitorimit nga muaji korrik, i cili do të zgjasë deri në mars të vitit të ardhshëm. Projekti synon përmirësimin e performancës së anëtarëve të Kuvendeve Komunale dhe forcimin e llogaridhënies e transparencës së tyre. Projekti bashkë financohet nga Bashkimi Evropian, Qeveria e Zvicrës, Qeveria e Suedisë dhe Helvetas.

Monitorimi do të bazohet në tri role kryesore të anëtarëve të Kuvendit:
1. Roli përfaqësues – do të vlerësohet angazhimi i anëtarëve në takimet me qytetarë, këshillat lokalë dhe grupet e tjera të interesit, përfshirë grupet e margjinalizuara, si dhe mënyra se si kërkesat e qytetarëve adresohen në seancat e Kuvendit.
2. Roli legjislativ – do të vlerësohet kontributi i anëtarëve përmes diskutimeve, propozimeve dhe rekomandimeve gjatë shqyrtimit dhe miratimit të akteve komunale.
3. Roli mbikëqyrës – do të vlerësohet angazhimi i anëtarëve në kërkesat për llogaridhënie ndaj ekzekutivit dhe në shqyrtimin e dokumenteve e çështjeve të paraqitura në Kuvend.
I gjithë procesi do të mbështetet në dokumente dhe dëshmi konkrete, përfshirë procesverbalet e seancave dhe takimeve, si dhe dëshmi të tjera relevante.
Në përfundim të procesit, do të ndahen tri çmime në nivel të Kosovës:
Çmimi për anëtarin më aktiv;
Çmimi për anëtaren më aktive;
Çmimi për anëtarin më aktiv në mandatin e parë.
Nga procesi i vlerësimit përjashtohen Kryesuesi i Kuvendit dhe shefat e grupeve, duke marrë parasysh rolin, përgjegjësitë dhe angazhimet e tyre në organizimin dhe koordinimin e punës së Kuvendit. Qëllimi është që vlerësimi të pasqyrojë në mënyrë sa më të drejtë punën individuale të secilit anëtar të Kuvendit.
Gjatë seancave do të jetë i pranishëm monitoruesi i projektit.
Nëse keni ndonjë pyetje, me kënaqësi mund t'u përgjigjem.
Ju falënderoj për vëmendjen dhe bashkëpunimin.

Kryesuesi i Kuvendit-Selajdin Troni: Vazhdojmë tutje, kushte pune që të mbahet mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VIII-të të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2026 të Legjislaturës së 8, data 29.09.2026, me këtë:

REND PUNE

1. Propozim Deklaratë për shprehjen e mospajtimit me dënimin e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Gjykata Speciale në Hagë;

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

3. Raporti Gjashtëmujor i KKSB për periudhën janar- qershor;

4. Propozim-vendim për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029 - për shqyrtim dhe aprovim;

5. Raport Periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025

6. Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite;

7. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës se paluajtshme të Komunës;

8. Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2025-2026;

9. Informatë fillimi i vitit të ri shkollor 2026-2027 në Komunën e Kaçanikut;

10. Plani Komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Kaçanikut;

11. Propozim Vendim për Miratimin e raportit përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e breshërit.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Nuk u paraqit kusht. Atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Konstatohet se KK,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 11 pikave.

Kalojmë në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës

1. Propozim Deklaratë për shprehjen e mospajtimit me dënimin e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Gjykata Speciale në Hagë;

Kryesuesi i Kuvendit-Selajdin Troni: E lexoj Propozim Deklaratën si vijon:

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, pas diskutimit të përbashkët të përfaqësuesve të gjitha subjekteve politike, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.09.2026, shpreh mospajtimin e tij me dënimin e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Gjykata Speciale në Hagë.

Për Komunën e Kaçanikut, kjo çështje ka një peshë të veçantë, sepse kujtesa e qytetarëve tanë është e lidhur drejtpërdrejt me sakrificën dhe vuajtjet e përjetuara gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Në kujtesën e Kaçanikut mbeten përgjithmonë masakra e Kotlinës, e Rakocit, e Lagjes së Re, e Ivajës, Sllatinës, Gjurgjjedullit, Stagovës Biçecit, Gajres, Gabrricës, Dubravës, Nikaj si dhe krimet e kryera në shumë lagje e fshatra ku u vranë civilë të pafajshëm e ranë dëshmorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këto ngjarje përbëjnë ndër plagët më të rënda të historisë së komunës sonë dhe dëshmi të sakrificës së qytetarëve të Kaçanikut për lirinë e Kosovës.

Në rrethanat kur krimet e kryera ndaj popullsisë civile të Kosovës ende nuk është vendosur drejtësi, e ky vendim prek thellë ndjenjën e drejtësisë dhe dinjitetin e qytetarëve tanë.

Duke pasur parasysh se vendimi u shpall me formulimin **"Në emër të popullit të Kosovës",** Kuvendi i Komunës së Kaçanikut përcjell qartë mesazhin e qytetarëve të saj:

"JO NË EMRIN TIM!"

Si shprehje e mospajtimit me këtë dënim dhe të drejtës për të kërkuar drejtësi për udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi.

E hapi diskutimin: Nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 20.

Konstatoj se Kuvendi i Komunës njëzëri e mbështetën këtë:

DEKLARATË

Për shprehjen e mospajtimit me dënimin e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Gjykata Speciale në Hagë;/ Lënda: 01Nr. 60/01-26133/26.

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: A ka dikush diçka rreth procesverbalit, nëse jo e hedhim në votim, me 20 vota për, asnjë kundër, dhe asnjë abstenim konstatoj se kuvendi komunal:

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja VII (shtatë) e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2026, të datës 29.07.2026/ Lënda: 01Nr. 060/01-8988/2026.

Pyetjet dhe Kërkesat

Ardita Rrahmani: Me sa di unë procedurat për tenderimin e ndërtimit të ShFMU "Emin Duraku" kanë përfunduar. A mund të di më shumë nga ju për këtë çështje?

Jeton Luma: E kam një propozim të cilin e konsideroj jo vetëm institucional, por edhe si detyrim njerëzor e moral ndaj qytetarëve tanë, e në veçanti ndaj personave me nevoja të veçanta. Duke marrë parasysh se komuna nuk ka ndonjë zyrë apo mekanizëm të posaçëm të dedikuar ekskluzivisht për persona me nevoja të veçanta, kjo kategori mbetet shpesh e izoluar dhe e lënë pas dore. Shumë familje që përballen me kushte të rënda ekonomike, e kanë të pamundur të sigurojnë pajisje ndihmese mjekësore, si karroca, aparate dëgjimi, shkopinjtë, orientues, proteza etj. Në nivel qendror për shkak të kërkesave të shumta, pritjet janë tejet të gjata, ndërsa në nivelin lokal mungon një adresë e qartë, se ku këto familje të drejtohen që të marrin mbështetje të nevojshme. Për ti dhënë zgjidhje institucionale këtij problemi, propozoj të krijohet një fond komunal, përmes së cilës Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale,, do të krijoj një linjë të veçantë buxhetore, të dedikuar për mbulimin ose bashkëfinancimin në rastet e kostove me të mëdha, për blerjen e pajisjeve ndihmese për personat me nevoja të veçanta. Gjithashtu edhe brenda kësaj drejtorie, mundësisht të caktohet një zyrtar përgjegjës, i cili do të shërbejë si pikë referente për këtë kategori të ndjeshme, duke i regjistruar nevojat, duke i udhëzuar familjet dhe duke menaxhuar në mënyrë transparente dhe të drejtë mbështetjen e dedikuar për ta. Besoj se vlera e vërtetë e një shoqërie matet me kujdesin që tregon ndaj atyre që kanë më së tepërmi nevojë. Prandaj konsideroj se kjo kategori e veçantë se bashku me familjet e tyre meritojnë një trajtim me të veçantë, me të dinjitetesh dhe më njerëzore.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje e kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën e tretë:

3. Raporti Gjashtëmujor i KKSB për periudhën janar- qershor;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

Ernesta Krasniqi: Raporti i KKSB, dimë që ai është raporti më i lartë i sigurisë, andaj ai duhet të jetë i bazuar dhe i saktë, ai jep shumë ë. Por jo masa për ato probleme, përmenden 36 raste prej tyre 29 vepra penale dhe 7 kundërvajtje por nuk tregon se sa kanë qenë në janar 2025. Nuk ka statistikë se nëse numri është rritur apo ulur, në mbledhjen e 3të thuhet se rastet kriminale kanë shënuar rënie por nuk jep asnjë të dhënë se ku bazohet ky raportim, janë dhënë 15 rekomandime por nuk specifikohet asnjë institucion, afati për zbatim burimi i financimit, në të njëjtën kohë me frazën se gjendja në qytetin tonë është e menaxhueshme dhe e qetë përmendet dhuna në familje, narkotikët siguria në trafik, mungesa e stafit tek zjarrfikësit, raporti thotë se ka nevojë për kapacitet por nuk dimë asgjë për të dhënat aty. Përderisa nuk i kemi këto ne nuk mundemi me kuptua se sa i madh është problemi, kamerat e sigurisë a janë funksionalizuar? Nëse këto statistika janë më shumë se një procesverbal un nuk mundem me kuptua se si mundet me u raportua qe situata në qytetin tonë është stabile dhe e qetë.

Brahim Imishti: Unë desha shumë me përgëzua Ernestën për punën e bërë në kuadër të sigurisë publike, funksionalizimi i kamerave në nivel komunal, e ke bërë shumë të bujshme këtë çështje, por nganjëherë duhet edhe me përgëzua për punët e bëra.

Ernesta Krasniqi: Në rekomandime kërkohet funksionalizimi i kamerave të sigurisë pra raporti s'tregon se sa kamera ekzistojnë.

Brahim Imishti: Kjo është në kuadër të Ministrisë së Brendshme.

Ernesta Krasniqi: Unë kam shumë dëshirë që të jetë ashtu, kemi shumë çështje të tjera që duhen të adresohen si narkotikët, në raport përmendet jo vetëm përdorimi por edhe furnizimi dhe shpërndarja, por s'jep të dhëna konkrete, a ka ndonjë rast me të mitur, çfarë masa janë marrë në komunitet dhe shkolla pa të cilat është vështirë me marrë pjesë.

Sabedin Vishi: Ju përgëzoj për deklaratën, ke të drejtë për raportin Ernesta që është i mangët, jemi mundu për kamerat me i funksionalizuar, dhe ia kemi dal, por për shtimin e tyre ajo nuk ka qenë në kompetencë tonën, po shkak i përgjegjësisë jemi detyrua të gjejmë forma te ndryshme për funksionalizimin e tyre, kemi bë plan ti monitorojmë pikat e afërta nëpër shkolla, është diskutuar edhe për personat me aftësi të kufizuara të ketë pjerrina. Është diskutua për pastërtinë, ku është marrë edhe një aksion më 22 prill, që ka vazhdua në mënyrë sistematike, ka qenë si temë edhe ujërat e zeza, sinjalizimet, në momentin e lidhjes së kontratës do vendosen, ka është shumë tema të tjera, por pajtohem qe është në rritje çështja e dhunës në familje dhe kështu po mundohemi të punojmë në këtë drejtim.

Ernesta Krasniqi: A kemi numër të saktë për numrin e punëtorëve që mungojnë, dhe rastet e dhunës në familje, se këtu në raport nuk thuhet?

Kryetari i Komunës- Sabedin Vishi: Ne jemi shumë të kënaqur me zjarrfikësit, por për një pjesë tjetër ne nuk kemi kompetenca, për çdo rekrutim e gjera tjera është përgjegjëse AMA, dhuna në familje ka qenë një rast por është zgjidh si problem, gjë kryesore që mendoj unë. Për hir të opinionit i thashë të gjitha ato që unë i mbaj mend.

Heset Malsiu: Për mua është një raport i mangët dhe është problem të epët një mendim nga ne, koncepti i sigurisë është i mangët.

Jeton Luma: Edhe unë po mendoj qe ai duket si një procesverbal, diçka qe me ra në sy është edhe rritja e bullizimit, përveç në shkolla edhe online, ndoshta ka diçka që e keni diskutua live, a keni diçka për këtë çështje.

Gazmend Bunjaku: Kemi arrit një marrëveshje me një organizatë që të mbahen ligjërata të veçanta në lidhje posaçërisht për këtë çështje, do merren edhe masa tjera po sa për fillim kemi bë këtë gjë.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo pikë kalon si informatë. Konstatoj se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Me aktivitetin e KKSB, përmes Raportit Gjashtëmujor i KKSB për periudhën janar-qershor/Lënda: 01Nr. 104/02-24608/26.

Vazhdojmë me pikën tjetër

4. Propozim-vendim për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029 - për shqyrtim dhe aprovim;

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtori i DBF, Valdrin Dogani:

Valdrin Dogani: Sot para jush paraqesim Propozim-Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2027, si dhe vlerësimet buxhetore për vitet 2028 dhe 2029.
Buxheti i përgjithshëm për vitin 2027 është planifikuar në shumën prej **14 milionë e 60 mijë e 883 euro**. Nga buxheti i vitit 2027, **12 milionë e 857 mijë e 496 euro**, apo **91.44%**, janë mjete nga grantet qeveritare, ndërsa **1 milion e 203 mijë e 387 euro**, apo **8.56%**, janë të hyra vetanake komunale. Sa i përket strukturës së shpenzimeve, **10.62 milionë** janë paraparë për shpenzime operative që shërbejnë për funksionimin e rregullt të Komunës së Kaçanikut, ndërsa **3 milionë e 431 mijë e 885-euro** për investime kapitale.
Sipas kategorive ekonomike, janë planifikuar mbi **8 milionë euro për paga dhe shtesa**, rreth **1.56 milionë euro për mallra dhe shërbime**, **279 mijë euro për shpenzime komunale**, **695 mijë euro për subvencione dhe transfere**, si dhe mbi **3.43 milionë euro për investime kapitale**. Ky buxhet është hartuar duke marrë parasysh edhe kërkesat dhe prioritetet e qytetarëve, të paraqitura gjatë dëgjimeve buxhetore të mbajtura gjatë procesit të planifikimit. Këto kërkesa janë trajtuar gjatë procesit të planifikimit, në përputhje me mundësitë financiare, kufijtë buxhetorë dhe prioritetet e komunës. Kuptohet, jo çdo kërkesë mund të përfshihet brenda një viti buxhetor, mirëpo synimi ka qenë që buxheti të reflektojë sa më mirë nevojat reale të qytetarëve dhe të sigurojë një shpërndarje sa më të drejtë dhe racionale të fondeve. Përmes këtij buxheti synojmë vazhdimin e investimeve në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, kulturë, rini e sport, bujqësi dhe sektorë të tjerë me rëndësi për qytetarët e Komunës së Kaçanikut. Ju faleminderit dhe jam para jush për pyetje dhe sqarime shtesë.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

Kadrije Lika Troni: Buxheti i komunës për vitin fiskal 2027 siç e tha edhe drejtori është në shumën 14 milion e 60 mije e 883 euro. Falënderojmë edhe Qeverinë për rritjen dhe mbështetjen financiare të komunave. Dua të diskutoj për disa kërkesa te cilat i kam bërë dhe më herët dhe duhet të reflektonin ne buxhetin e projektet e bitin 2027. E para është tregu i

qytetit, Kaçaniku nuk ka treg, kam kërkua që ky problem të trajtohet dhe të parashihet si prioritet. Por nuk ka zënë vend. E dyta është fëmijët me nevoja të veçanta, të bëhen disa analiza që sadopak të mbështeten këta fëmijë financiarisht. E treta është tek projektet, arsimi para fillor, të rregullohet oborri dhe të rregullohet muri mbrojtës tek Çerdhja Agimi, janë ndarë 110 mijë euro për këtë projekt të ri, i cili nuk ka akoma as 5 vite, po planifikohet të investohet sërish, kjo është harrnim i punëve të vjetra. Rruga Stagovë-Runjevë është viti i tretë që po ndajmë mjete dhe ende nuk kemi arrit me e bë atë lidhje, mos të harrojmë edhe grantin Qeveritar. Tek urbanizmi ceket rehabilitimi i rrugës Skënderbeu, projekt shumë i mirë po ti kishim të rregulluara të gjitha rrugët e tjera, kemi rrugën: "Emerllah Kuqi" në Kaçanik, qe është aq e pa shtruar e qytetarja ka pësua incident kirurgjik, Shtëpinë e të nderuarit Ismail Raka, nuk ka infrastrukturë rrugore.
Tjetra unë kam edhe një pyetje. Sa prej këtyre investimeve janë projekte të reja dhe të bartura, cilat kanë financim për tu përfunduar dhe cilat ka buxhet të ndarë vetëm simbolikisht. Ndërtimi i rrugës: "Reshat Shehu" me trotuar, a po bëhet fjalë për lagjen Rakoc ku doni ta bëni atë trotuar? pasi po mendohet zona e Kërbliqit për turizëm pse nuk mendohet ndonjë plan më i përshtatshëm, ku mendoni ju me bë atë trotuar, aty s'ka vend. Tjetra, rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale dhe urbane të Kaçanikut, pse nuk po ceken me fjalë këtu se cilat rrugë, 550 mijë euro ndahen ne nuk e dimë ku do ndahen këto para, qytetari s'është i njoftuar për asgjë, tek asfaltimi i rrugës për Krivanjevë, a është shpallë si zonë Turistike? Kush e ka shpall? Sipas cilës hartë zonale?

Heset Malsiu: Këtu tek tabela bien në sy kjo, se projektet nuk janë të specifikuara dhe cilat lokalitete përfitojnë nga këto të ardhura, janë mbi 2 milion euro deri në vitin 2029 që nuk dihet se ku do shkojnë, janë shumë gjithëpërfshirëse, ne nuk mund ta votojmë një buxhet të cilin nuk e dimë ku do shkojnë këto para, komuna ka shpall si prioritet zhvillimin ekonomik, këto 550 mijë euro po të investoheshin në rrugën Silcapor- Rakaj skish pas nevojë të zgjatej 3 vite.

Bashkim Krasniqi: Para vetes kemi propozim Buxhetin, duke pa shifrat shohim se rreth 91% janë grante qeveritare, kurse 8.56% te hyra vetanake shuma ma e madhe shkon për funksionin e komunës kurse tjetra shkon për projekte, unë mendoj qe si prioritet për komunën tonë ka qenë uji, impianti dhe shkolla "Emin Duraku", falënderojmë kryetarin për marrëveshjen e ujit, investimet tjera kapitale mendoj qe janë nda në mënyrë të drejtë, diçka që me ka bë përshtypje ka qenë edhe strehimi i qenve endacak dhe blerja e makinerive për mirëmbajtjen e rrugëve, shumica e projekteve duhet të realizohen për 3 vite shkak i buxhetit të varfër, shkak edhe i problemeve me prokurimin, mendoj që ky buxhet është gjithë përfshirës.

Betim Shala: Kam vetëm një vërejtje me këtë çështje tek rruga: "Skënderbeu", ajo duhet të jetë pikë lidhëse me rrugën: "Agim Bajrami" dhe "Emsale Frangu" ka 890 metra, për aq mendoj që janë pak të ndara 100 mijë euro, trotuari në të gjithë rrugën nuk është funksional, të bëhet riorganizimi i rrugës, të ketë trotuar të paktën në njërën anë, të jetë funksional, pothuajse në asnjë pikë për momentin nuk është.

Ernesta Krasniqi: Për buxhetin mendoj që kemi shumë me diskutua, arsyeja pse mendoj që ka nevojë për diskutim është sepse nuk ka një planifikim konkret buxhetor. Sepse nuk është i qartë, kemi të bëjmë me emërtime të përgjithshme. Tek shërbimet Publike pika 15 thotë: Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në lokacione të ndryshme.

Valdrin Dogani: Për 2029 jeni duke fol, besoj që është pak herët me diskutua për këtë

Ernesta Krasniqi: Për vitet e tjera nuk është nda buxhet për këtë projekt është nda buxhet vetëm viti 2029, Nëse flasim për bujqësinë, pika 12. rehabilitimi i infrastrukturës bujqësore dhe rurale për vitin 2027 nuk është nda buxhet për vitin 2028, janë nda 80,000-euro ndërsa 2029, 100 mijë euro. Mendoj që te pika 18 ka nevojë të dihet detajisht se çka do shpenzohet. Pika 23. Cilat rrugë saktësisht, qysh bëhet një kod buxhetor se në cilat rrugë? Pika 24 në zonat rurale, cilat rrugë? Cilat janë ato rrugë që qytetarët presin me u shtrua? Për cilën rrugë po bëhet fjalë? A po përfshihen rrugët që janë me kërkesa të qytetarëve? Shëndetësia, pika 31, renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së objekteve të kujdesit parësor Shëndetësor në Komunën ë Kaçanikut, për vitin 2027 nuk ka buxhet, për vitin 2028, nuk ka buxhet për vitin 2029 janë nda 210 mijë euro, edhe këtu janë të përgjithësuara, çka do të rinovohet? Cilat objekte? Në cilat do të investohet? Nëse është pa e rëndësishme pse s'janë nda këto dy vitet tjera buxhet? Pika 39, shërbime kulturore, ndërtimi dhe rehabilitimi i infrastrukturave për kulturë dhe sport, për vitin 2027 nuk është planifikua buxhet, për vitin 2028 janë planifikua 100,000-euro dhe për vitin 2029, 150,000-euro përsëri pyetja e njëjtë, cilat janë objektet? Cilat janë projektet? Pika 12, blerja e makinerive për mirëmbajtje e rrugëve, janë planifikua 580,000, duke marr parasysh qe bëhet përmes kompanive private pse po bëhet kjo blerje? Dua të di për këtë rrugën: "Çlirimtari", sqarim konkret edhe për pikën 33, çfarë lloj qendre?

Ardita Rrahmani: Kjo është pika që sjell më së shumti diskutim dhe që sjell informata se ku po drejtohet ekzekutivi, nuk mundem pa i përshëndet 3 projekte kapitale që janë të domosdoshme për komunën e Kaçanikut, ndërtimi i parkingut, rruga: "Skënderbeu", kam një kërkesë që ka të bëj në drejtorinë e arsimit, kategoria e mallrave dhe shërbimeve, kam diskutua edhe në KPF dhe ka tregu që ka edhe mjete me të cilat mundemi me punua, në koordinim me rrjetin e grave, është kërkua që të futet si kod i vetëm apo se si duhet por ka të bëj me futjen e produkteve menstruale si të qasshme nëpër shkolla, kjo do të shërbej për shkollat e mesme, shpresoj që kjo të aprovohet sepse është e nevojshme.

Brahim Imishti: Te investimet kapitale e uroj kryetarin për vendosjen e gur themelit të sallës sportive në Dubravë dhe terrenit sportiv, urës në Stagovë, edhe pse parafolësi e përmendi çështjen ujit, unë e përgëzoj edhe për nismën e fabrikës së ujit.

Bashkim Krasniqi: Këto vërejtje munden me qenë me vend por unë po i shoh si politike, kryesuesi ka organizuar edhe dëgjim publik, në të cilin ju nuk keni marrë pjesë. Me pas me t vërtetë ndoshta ishit ardhur e kishit marrë pjesë dhe i kishit shpreh shqetësimet, nëse keni pas vërejtje është deshtë me ardhur.

Hafize Sallahu: Unë desha të ndërlidhem tek buxheti shkak se nuk e pata shumë të qartë këtë pikën për blerjen e makinerive për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe parqeve, si është mundu me funksionuar kjo? Unë nuk po çuditëm që nuk janë të cekura tek pika Mallra dhe Shërbime sepse herë pas herë ndodhin dëmtime që nuk mundemi me i parashikua.

Kjani Zeneli: Më habit fakti që është shpallë zonë turistike Krivanjeva dhe nuk e di kush. Tek shtëpia e Heroit Ismail Raka, nuk e di çka është parapa me u punuar aty, pasi që është dëmtua aq shumë. Pse rruga: "Avdulla Baftiu" është largu herë pas herë, sa i përket dëgjimit publik ne e dimë sa merret parasysh ato kërkesa.

Ardita Rrahmani: Unë kam qenë pjesë e opozitës, e kam bë kërkesë që ka qenë kërkesë që më është realizua, unë marr pjesë në të gjitha debatet publike.

Hafize Sallahu: Mandatin e kaluar, ka pas shumë kërkesa në dëgjime publike që janë realizua. Jo vetëm ne por edhe qytetarët mungojnë në debate publike.

Kjani Zeneli: Unë i kam bë deri tash 20 kërkesa që nuk janë realizua. Unë të mirën e them të mirë, të keqën të keqe.

Valdrin Dogani: Rruga tek Shtëpia Muze e Ismail Rakës, MZhR, ka kërkua projekte të cilat komuna shpreh interesim për bashkë financim dhe e kemi dërgua projektin por nuk kemi marrë përgjigje. Sa projekte të reja dhe sa ekzistuese: kemi 16 projekte të reja dhe 18 të vjetra. Ndjej keqardhje për rastin në rrugën Emërllah Kuci, mendoj që nuk mundemi me i cek si investime kapitale, aty afër do bëhet edhe një mur mbrojtës për 2027. Nuk janë dëgjua kërkesat, do bëhet strehimore për qentë endacak, muri mbrojtës tek çerdhja "Agimi", përveç asaj edhe oborri. Tek rruga Runjevë-Stagovë, e kemi fillua fazën e parë, pat shembje të dheut tash pritet asfaltimi, është tenderua. Rruga Skënderbeu, e përmendi Betimi, tek makineritë, gjatë dimrit po kemi gjithmonë vështirësi tek kontraktimi i kompanisë, që të angazhojmë punëtorë ta kryejnë punën tonë, këto ankesa po u leverdisin më shumë. Tek ndërtimi për ofrimin e shërbimeve rezidenciale, i dedikohet personave në moshë apo aftësi të kufizuara, ne e kemi Hendikosin në Kaçanik, pika turistike në Krivanjevë, është shpall si pikë turistike jo zonë. Ndërtimi i rrugës" "Reshat Shehu" me trotuar, besoj që ka vend me u bërë sepse për at janë projektet, buxheti planifikohet për vitin e ardhshëm, tjerat vite janë vetëm vlerësime, nëpër fshatra kanë kryetarët e këshillave qe shpalosin nevojat e tyre. Dëgjimi publik është për të gjithë.

Jeton Luma: Sa i përket buxhetit u thanë prezenca në dëgjime publike, asamblisti është urë lidhëse me kuvendin dhe qytetarët, unë kam be një mori kërkesash të cilat nuk janë përfill fare, si mundem me votua unë një buxhet për të cilën nuk ka asnjë kërkesë timen nga qytetarët, prioritetet tek ky, ne kemi bujqësinë shëndetësinë arsimin dhe zhvillimin ekonomik, ju keni nda shuma shumë të vogla për këto prioritete, për zhvillimin ekonomik keni nda 110 mijë euro, e përmendi kolegët parkingun tek QKMF, për kënd po destinohet ky parking? Dua të me shpjegohet kjo, pse duhet të futet tek shëndetësia, keni 4 fushat kryesore me investime absurde.

Valdrin Dogani: Jeton i përmendi investimet por përmende vetëm investimet kapitale, ne tek këto fusha japim edhe subvencione, sa i përket parkingut do të bëhet një projekt me 4 kate parkim.

Kryetari i Komunës: Diku pajtohem me këto kritika diku jo, unë me plot përgjegjësi them se këto projekte janë në përputhje me kërkesat ë qytetarëve. Kemi nis fabrikën e ujit, kërkesë e juaja dhe qytetarëve. Parkingu ka qenë kërkesë e juaj dhe qytetarëve, Dukuria e qenve endacak ka qenë kërkesë e qytetarëve edhe juaja, a ka qenë kërkesë e juaja salla e kuvendit po, a ka qenë kërkesë e juaja dhe e qytetarëve terrenet sportive, të gjitha këto janë të argumentuara. Sa i përket kërkesave tjera ato janë me kode të cilat duhet me u bërë procedura tjera. Sa i përket rrugëve rurale dhe urbane përderisa ne na e lejon një kod do e bëjmë. U përmend muri i çerdhes, ne kemi mëndua se do filloj puna tek Emin Duraku. Impianti ujit po vonohet shkak i institucioneve por e kemi parapa të mundohemi maksimalisht. Tek rruga Runjevë-Stavogë me të vërtetë e kemi humb grantin nga vonesat e

ankesave nga kompanitë. Për mirëmbajtjen e rrugëve do bëjmë cmos që të bëhet siç është sa më mirë. Tek Krivanjeva, e kemi bë si komunë zgjerimin e rrugës me bazë dhe duhet të vendosim asfalt ta ruajmë atë dhe nuk kemi nevojë ta shpenzojmë më vonë dyfishin, që ne mendojmë me e bë zonë turistike. Tek pjesa e rrugës "Ismail Raka", po në bazë të kërkesës së juaj mjetet e kalldrëmeve që nuk janë shpenzua s'kemi mund me i dërgua diku tjetër pos aty afër. Tek rruga: "Emërllah Kuqi" është e vërtetë se është keq, ne e kemi bë me beton dhe me pllaka të betonit po synojmë ta bëjmë. Tek rruga "Reshat Shehu", atë projekt që e keni, e kemi bërë një projekt detal.

Kadrije Lika Troni: Duhet të bëhet rruga siç duhet, ose të mos bëhet fare.

Kryetari i Komunës: Kadrije është mirë me u angazhua edhe ti me e shty përpara.

Ernesta Krasniqi: Pse kur të ka thënë ministri për kolektorin janë mjetet e ndara, vetëm hajde nënshkruaj, pse nuk ke shkuar? Pse nuk keni aplikua e me nënshkrua?

Kryetari i Komunës: Atëherë unë nuk kam qenë Kryetar, kam qenë nënkryetar. Që thatë për debatin publik ndoshta e kishim përmirësua diçka. 110 mijë euro tek zhvillimi ekonomik kontribuojnë shumë fusha tjera, dhe aq kemi mundësi, tek tregu i qytetit, s'kemi parapa diçka por me kalimin e kohës e shohim.

Jeton Luma: Shpesh thua qe mirë është me thënë se kur punohet diçka dhe mirë me kritiku kur nuk punohet, por ti e din që ka pas projekte nga qeveria, e ke rrethin te fusha e pajtimit, e ke rrugën në Kerbliq, Rruga Gllobogicë-Doganaj, Çerdhja etj. Ju be kryetar çka keni bë? Për banimin Social Adekuat, kanë aplikua 24 komuna, pse ju nuk aplikuat?

Kryetari i Komunës: Vitin e kaluar është kjo shpallje, ne këtë shpallje kam lajmërua qytetarët se pse nuk është aplikuar dhe nuk kam pse me të dhënë shpjegim ty, me zotimin tonë kemi thënë se me bërë transportin publik falas e kemi bë, kemi rrit numrin e bursave, kemi digjitalizua shkollat, kemi terrene sportive, Fabrikën e ujësjellësit, 200€ për lehonat i kemi bë.

Jeton Luma: Detyra jote është be kryetar me shkua me kërkuar tek niveli qendror, për projekte që janë jetike nuk është marre me kërkuar nëpër dyert e ministrisë, ju e keni pasë pushtetin 21 vjet bre, keni qeveris edhe në nivel qendror.

Kryetari i Komunës: Çdo gjë që vjen nga RKS është në interes të krejt qytetarëve. Ne duartrokasim çdo projekt. Ne nuk duartrokasim investimet qe nuk janë bë tek ne, e në komuna më të vogla akoma më shumë.

Hafize Sallahu: Është e turpshme me thënë se nëse kisha fitua unë kisha pru investime, un mundem me e dëshmua sa emaile i kam dërgua dhe skam marrë përgjigje. Më janë premtua takime e nuk janë realizua. Çdo qytetar që mundet me nxjerrë nga qeveria diçka është i mirëseardhur.

Kadrije Lika Troni: Ne nuk kemi ardhur këtu me ju pëlqyer juve, na ke lodh prej se ke ardhur tu na tregu çka ka ndodh në qeverisjen tënde.

Ardita Rrahmani: Është mirë me debatua për buxhet po ne po dalim nganjëherë krejt prej teme. Jetoni përmendi emrin tim dy tri herë, e mbaj mend mirë se cili mundet me qene roli i asambleistëve, kam qenë në vitin 2016 kam qenë pjesë e kabinetit në ministrinë e infrastrukturës, dhe Kaçaniku ia ka pa hajrin sepse e ka pas ministër Lutfi Zharkun, dhe a e din pse se ka pas asambleista që kanë pi një kafe më të e ndoshta kanë ardhur edhe në zyre të ministrit që kanë pas apo s'kanë pasur termin, dhe e janë pranua për çfarëdo lloj kërkese. Kam emaile, jam drejtua si asambleiste në ministrinë e financave, ama kurrë s më është kthye asnjë email, për impiantet e ujërave të zeza, po te isha në vendin tënd të kisha subjektin tim politik në nivel qendror ai ministër skish mund asnjëherë me fjet rehat, mos i ndëshkoni qytetarët për inate politike.

Jeton Luma: Sa i përket impaktit tim, unë njoh ish zëvendës ministrin që 4 vite, unë i kam përmend dy probleme, problemet e malit (drunjëve) dhe rrugën e Glloboqicës. Autostrada jonë llogaritët si rrugë qorre, qeveria atëhershme është dashtë mi bërë pyetje se pse ka mbet si zonë e pa zhvillua.

Ernesta Krasniqi: A ka mundësi me i marr përgjigjet e pyetjeve të mëhershme? Për blerjen e makinerive dhe a kemi kontratë aktive? The qe nuk ka aktive. Në E-prokurim po thotë se ka kontratë aktive deri në vitin 2028, çka ndodh me këtë kontratë?

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtori i DSHPE, Arian Teneqja.

Arian Teneqja: Siç e dini mirëmbajtja e hapësirave publike në Komunën tonë bëhet përmes 3 kontratave, me Pastërtinë, ajo verore dhe dimërore. Më këto blerje kemi mëndu me bë tek parqeve dhe ndihmë tek "Pastërtia", këtu është menduar që të bëhet kontrata që të zhvillohen më mirë procedurat. Ne rrugën: Runjevë-Stagovë, ne jemi mundu që të paktën ta lidhim këtë rrugë, është mirë që të na ndihmoni pasi jeni në qeverisje, ky projekt është buxhetuar në vitin 2026, të loboni sa më parë të tenderohet. Unë kam kontaktua me ta që të bashkëpunojmë, kjo rrugë është mirë të vazhdohet.

Heset Malsiu: Nuk duhet të jemi shumë nervoz me njëri-tjetrin, në herën e kaluar i kemi lavdërua projektet por me i dhënë vetes kredit për kaq pak punë, projektet që janë për tu lavdëruar duhet, edhe nëse makineritë do bëhen si investim në KRM Pastërtinë,

Ernesta Krasniqi: Më duhet me diskutua për kontratën, po dua me u bërë një pyetje, kur keni pas 10 cent kilometri, se keni pastrua, kur kilometri 35€ kilometri keni dal me pastrua, sepse jeni kanë të interesuar me përfitua kompania.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse nuk ka dikush diçka e hedhim pikën në votim. 12 votë Për, 5 votë Kundër dhe 2 Abstenime. Prezentë 19. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori:

VENDIM

Për Miratimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029/ Lënda: 01Nr. 104/02-23559/26.

Pas kësaj pike u bë një pauzë 10 minuta.

Kryesuesi i Kuvendit: Vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Prezentë për momentin janë 16 anëtarë.

5. Raport Periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025;

E hapi diskutimin:

Kadrije Lika Troni: Raporti tregon se nga 13 rekomandime janë zbatuar vetëm 4, 7 pjesërisht dhe të pa zbatuara janë 2, vetëm desha me pyet kryetarin se njësia e auditimit të brendshëm po funksionon vetëm me një auditor, ku kërkohen të paktën 3, dhe pse nuk është zbatuar.
Valdrin Dogani: Siç the edhe ti se duhet të kemi tre sipas buxhetit tonë, po shkak i stafit, pozitat te zyra e kryetarit janë të zëna, nuk mundesh me punësua nëse nuk ka buxhet.

Jeton Luma: Nuk e di nëse auditori është vetëm në detyrë apo në pozitë të rregullt? Sepse shoh shumë pozicione që janë ushtrues detyre.

Valdrin Dogani: Jo ka qenë me konkurs të rregullt!

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo kalon si informatë. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Me Raportin Periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025/ Lënda: 01Nr. 400/01-25390/26.

Kalojmë tek pika tjetër.

6. Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite;

Fjalën e ka drejtori i DUKMM, Korab Krasniqi

Korab Krasniqi: Kjo pikë ka të bëjë me propozim vendimin paraprak, këtu shkruan gabim duhet "deri" 99 vite. Kemi me votua një listë më të kufizuar, pas aprovimit komisionit i takon vetëm me i dhënë pronat.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

Kadrije Lika Troni: A kanë studim ekonomik këto prona të cilat ne po duam të japim për 99 vite.?

Korab Krasniqi: Deri 99 vite d.m.th nga 15, deri 99, varët nga komisioni se si vendosin me i dhënë.

Kadrije Lika Troni: Në bazë të raporteve të mëhershme, sa është rrite numri i të punësuarave në bazë të planit dinamik nga marrja në shfrytëzim nga kompanitë tjera apo ndoshta në nuk po shohim ekonomikisht rritje aspak.

Korab Krasniqi: Për ma detajisht ndoshta e shihni në raportin 6 mujor.

Heset Malsiu: Këto pronat në Ivajë a janë tek liqeni?

Korab Krasniqi: Disa janë afër liqenit, por ta kemi parasysh se nuk mundemi me thënë se do të epën n të gjitha pronat në shfrytëzim mund të ndodhë që vetën 2/3 prona të epën.

Heset Malsiu: Kemi bë një këmbim prone aty para disa herësh që të lirohet liqeni, a ka mundësi që të epën, ka qenë mirë që të hiqen nga kjo listë?

Ernesta Krasniqi: A është i përcaktuar qëllimi nga 2025 dhjetor nga mos përcaktimi i viteve është kthye negative sepse është kërkua edhe qëllimi e destinimi i listës se pronave, duke qenë se nuk janë këtu a ka mundësi që të ndodhë e njëjta?

Korab Krasniqi: Kur e kemi votua listën e veçantë të pronave ka qenë qëllimi, besoj edhe këtu njëjtë është.

Kadrije Lika Troni: A janë të përcaktuara kushtet, a ka fillua ndërtim atje tek zona e liqenit? Zakonisht inspektorati nuk po e kryen punën siç duhet.

Korab Krasniqi: Para se të merret leja do ketë kushte të cilat duhet përmbushur.

Bashkim Krasniqi: Dhënia e pronave në shfrytëzim është mirë për komunën tonë, pasi që ndikon në ekonomi mirëpo kam një vërejtje, po nëse konkurron për parcelën dikush, me marr më pak jo të gjithën.
Korab Krasniqi: Gjithsesi komuna e ruan të drejtën për me i parcielizua, nëse një parcelë kalon një rrugë mos me na dal problem me personin një fjalë.

Sabedin Rexha: Edhe unë mendoj njëjtë.
Hafize Sallahu: Pronat a janë private aty tek liqeni, me sa di s'kanë as kushte bazë për dhënie në shfrytëzim. Unë kam dal bukur moti prej aty, drejtori e pranoj se nuk ka. Megjithatë nuk është me rëndësi

Korab Krasniqi: Infrastrukturë bazë nuk ka, por vetëm investitorë serioz munden me e shty këtë çështje, këto prona nuk munden me qenë automatikisht të dhëna.

Sabedin Rexha: Ajo pjesë e ka ujësjellësin dhe kanalizimin, unë e kam bë vetë.

z. Selajdin Troni: Nëse nuk ka dikush diçka e shtoj pikën në votim. Rezultati i votimit, 15 votë janë Për dhe 5 votë Kundër. Abstenim nuk ka. Prezentë 20. Konstatoj se Kuvendi i Komunës mori:

VENDIM PARAPRAK

Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për 15-99 vite/ Lënda: 01Nr. 104/02-25436/26.

Kalojmë në pikën vijuese

7. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës se paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse nuk ka kush diçka, kalojmë në propozime konkrete:

Korab Krasniqi: Ekzekutivi ka propozua Rakip Vishin dhe Ardita Bekteshi,

Bashkim Krasniqi: Ne propozojmë Blerim Koxhën.

Kadrije Lika Troni: Ne propozojmë Enis Vishin.

Korab Krasniqi: Nga shoqëria civile propozohet Naim Hysa.

Brahim Imishti: Nuk pe di sa është e arsyeshme se pse me dërgua dikë në komision kur nuk e voton pikën.
Kadrije Lika Troni: Me ju kontrollua juve.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse nuk ka dikush diçka i shtroj në votim propozimet që dolën. Nga rezultati i votimit, shihet se 16 votë janë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 3. Prezent ishin 19. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori:

VENDIM

Për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 15-99 vite të pronës se paluajtshme të Komunës, në përbërje:

1. **Rakip Vishi anëtar (ekzekutivi)**
2. **Ardita Bekteshi anëtar (ekzekutivi)**
3. **Blerim Koxha anëtar (PDK)**
4. **Enis Vishi anëtar (LVV)**
5. **Naim Hysa anëtar (Shoqëria Civile).**

Lënda: 01Nr. 104/02-25434/26.

Kalojmë në pikën vijuese

8. Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2025-2026;

E hapi diskutimin:

Heset Malsiu: Unë e pashë këtë raport dhe nota mesatare ishte për me u kënaq, por nëse e krahason me kalueshmërinë në test të arritshmërisë, vërehet se nuk janë shumë reale. Nuk e di se drejtori a i beson shumë zyrtarëve të tij por iu kisha lut që me i kontrollua edhe disa gabime teknike. Nota mesatare nuk shënohet me përqindje. E njëjta gjë përsëritet.

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtori i DA, Gazmend Bunjaku.

Gazmend Bunjaku: Më herët në një seancë jemi të thirrur me i besuar arsimtarëve të lëndës, e drejtë ekskluzive e tij, po për atë pjesë janë inspektorati rajonal, edhe ne kontrollim të dokumentacionit edhe besoj qe dalin me raporte e rekomandime për plotësim ndryshime. Unë personalisht jam angazhuar në këtë drejtim dhe kam diskutuar këtë çështje të detajuara. Kam kërkua edhe raporte të këtyre analizave.

Heset Malsiu: Cilat janë masat që po merren për këto çështje, për përmirësimin e kësaj gjendje?

Gazmend Bunjaku: Sa i përket mungesave, objektivi jonë është zvogëlimi i tyre.

Bashkim Krasniqi: Si informatë e përgëzoj drejtorin sepse i kemi gjitha informatat e nevojshme, përndryshe sa i përket mungesave, është shqetësuese, kur ta shikosh se kur nxënësi kalon një cikël, suksesi i nxënësve vazhdon duke rënë, kam informata qe ende pa e krye shkollën nxënësit, shkolla profesionale nxënëseve u ofrohet punë, para disa dite drejtori i kësaj shkolle ka fituar një grantë 20 mijë euro. Njëjtë edhe të shkolla "Skënderbeu" po përgatit nxënësit që të hynë nëpër fakultete mjaft mirë.

Ardita Rrahmani: Te puna e migrimit te jashtëm apo të brendshëm a kërkohet një fletëtransfer?

Gazmend Bunjaku: Po por notat që nuk i ka mbetet i pa notuar.

Jeton Luma: Meqë jemi tek tema më të rëndësishme dhe ndieshme të shoqërisë, tek notimi po sa i përket arsimit fillor ka një mesatare 4.21, ndërsa arsimi i mesëm i ulët 3.74 atëherë po sa kalon nga një cikël në tjetrin ulet, pse me dal një rezultat i tillë, meqë është vetëm një mësues ndoshta notat janë më tepër se meritohen, pse ky ndryshim dhe a e keni mendua se çka mundet me qenë problemi. Plus, çështja e mungesave, është alarmante, bëhet fjalë për 98 mijë, 62 mijë janë të arsyeshme, 24.5 orë për kokë, kjo nuk është në rregull. Nuk duhet me ardhur me këto gabime janë 28.5 orë. Unë ashtu e pashë, ndërsa tek arsimi i mesëm ka 71.84 orë këtu ka një gabim në raport se është gjetur më i vogël. Kam edhe për provimin e maturës,

Gazmend Bunjaku: Tek çështja e arsimit fillor vet e përmende një mësues, plus në arsimin e mesëm të ulët mendoj që arsyeja është inkuadrimi i lëndëve të reja. Numri i mungesave është nga ata që nuk vijojnë, deri sa të arrijnë prindi me ardhur me të lajmërua, normal numri shtohet.

Kadrije Lika Troni: Te kjo pikë përveç numrit të rënies së nxënësve unë isha ndal tek nota mesatare e gjimnazit "Skënderbeu" që është 3.84 dhe IAP 2.89 nota mesatare, pse ka kaq dallim të madh tek dy gjimnazet, një prej faktorëve është edhe përdorimi i telefonave, çka do bëhet për ngritjen e cilësisë? E di që nuk është nda ndonjë fond për investim për kasaforta por kisha kërkua që ti dërgojnë nxënësit telefonat në një bankë.

Gazmend Bunjaku: Janë gjimnaze të ndryshme njëra shkollë profesionale dhe gjimnazi përgatit kuadro për shkolla të larta, kodi i shkollës e përcakton që ndalohet përdorimi i telefonave, po mendohet të investohet në kasaforta por varësisht nga buxheti shohim. Nxënësve edhe të mjekësisë po i subvencionojmë udhëtimin nga ky muaj. Do mundohemi ta ruajmë numrin e nxënësve.

Hafize Sallahu: Ka qenë kërkesë e imja edhe të shtohet mjekësia si drejtim.

Kjani Zeneli: Edhe unë do doja të ketë një paralele në mjekësi, ju përgëzoj që të paktën e paskeni pagua rrugëtimin nxënësve.

Gazmend Bunjaku: Nga ana teknike ne jemi në rregull, tenderimi është anulua për shkollën: "Emin Duraku", por pritet të hidhet prapë për tenderim. Diçka tjetër është edhe çështja e trafo stacioneve, deri sa se kemi ngrit ajo ka ndërtua shkolla çerdhe por ne nuk mundemi me bë planifikim e shumës. Pas kërkesës për shkollën në Nikaj dhe Doganaj, çdo objekt do njoftohet dhe KEDS që do fillojnë ndërtimet për këto të fundit. Për këtë vit nuk ka kod buxhetor për trafo.

Ardita Rrahmani: Tek digjitalizimi a trajnohet stafi paraprakisht për këto tabela?

Gazmend Bunjaku: Po, kanë.

Jeton Luma: Nuk morëm zotimin nga raporti, ka shumë gabime, nuk do duhet të arkivohet nga këto përgjigje tek mungesat ka gabime. Tek testi i arritshmërisë, nga 62 nxënës 25 kanë kaluar apo 41.6, por del 40.3. Duhet të jenë të sakta. Krejt në fund është edhe tabela e fundit, testi arritshmërisë nga 2016, nga 56% në 41.1% ne 2026. Ka rënie shumë të madhe të përqindjes. Unë do isha ndje shumë keq të isha në vend të juaj sepse janë ata fëmijët tanë.

Selajdin Troni: Diskutim tjetër nuk ka, edhe kjo pikë kalon vetën si informatë. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Informatën e DA për përfundimin e vitit shkollor 2025-2026/ Lënda: 01Nr. 04-610/01-25200/26.

Kalojmë në pikën vijuese:

9. Informatë fillimi i vitit të ri shkollor 2026-2027 në Komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

Jeton Luma: Ne vitin 2026 fillojnë vitin fëmijë që janë me nevoja të veçanta dhe familja e tyre me asistencë sociale detyrohet me ua paguar rrugëtimin për arsim fillor, ti kryetar vet i ke tre fëmijë.
Kryesuesi i Kuvendit: Keni dale komplet nga tema, nuk mundet me tregu askush se kush sa fëmijë ka këtu. Këtu mundesh me fol veç për pikën.

Jeton Luma: Jemi tu jetua në një kohë ku kemi kushte të rënda ekonomike, një fëmijë në Glloboqicë me nevoja të veçanta udhëton më shumë se 4 km. Drejtor shkolla fillore "Gafurr Luma" a ka arsimtar të Kimisë, a keni planifikua që edhe paralelja në kuadër të shkollës Dituria në Shtrazë të mbyllet apo jo.

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtori i DA, Gazmend Bunjaku.

Gazmend Bunjaku: Për çështjen e fëmijëve me nevoja të veçanta të gjithë atyre fëmijëve që u nënshtrohen komisionit komunal për vlerësim paguan 60/100-euro për çështje të transportin. Kërkesën duhet ta bëjnë tek ne për komision, që ta bëjmë kompensimin.
Tek çështja e Kimisë ka konkurs të hapur. Herën e parë është anulua se nuk i kanë plotësua kriteret. Sa i përket paraleles nuk do të mbyllet aspak.

Jeton Luma: Jemi në datën 29 shtator, kush u ligjëron atyre nxënësve lëndën e kimisë?

Gazmend Bunjaku: Ky është problem në gjitha vendet jo në këtë rast vetëm.

Samedin Rexha: Deri ta bëni një zgjidhje unë vullnetarisht shkoj u jap mësim atyre nxënësve pasi që edhe jam profesor i kimisë.

Heset Malsiu: Shkollat e mesme si e bëni planifikimin e nxënësve si të pranohen.

Gazmend Bunjaku: Parashikimi bëhet nga ministria, profesionale rreth 32, gjimnaz 28, po na ikin në komuna të tjera.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutim tjetër nuk ka, edhe kjo pikë kalon vetën si informatë. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Me Informatën e DA për fillimin e Vitit të Ri shkollor 2026-2027 në Komunën e Kaçanikut/Lënda: 01Nr. 04-610/01-25433/26.

Kalojmë në pikën vijuese:

10. Plani Komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Kaçanikut;

E hapi diskutimin:

Kadrije Lika Troni: Ky plan a vjen vetëm si plan apo votohet? Atëherë si mundemi ne të votojmë një plan ku baza e vendimit aty siç thuhet duke u bazuar në nenin …, cilin nen? Bazuar në statutin…. Cilin statut? D.m.th. kjo automatikisht duhet të vijë me përmirësim, dokumenti referohet vazhdimisht për emigrim gjatë viteve 2021-2025, plani është përpilua për vitin 2026-2028. A duhet të ketë strategji të re? Dhe kjo ka ardhur nga ushtruesi i detyrës sepse zyrtari/drejtori mungon. Tek Riatdhesimi.

Kryetari i Komunës: Kjo është një strategji e aprovuar nga qeveria e RKS, për personat për ri integrim dhe riatdhesim kjo është dokument që e hartojnë gjitha komunat, e ka hartuar ai ushtruesi i detyrës i cili për momentin nuk është këtu, nëse ka ndonjë gabim duhet me u shty për mbledhjen tjetër por ky është dokument që nevojitet për të gjitha komunat për koordinim të këtyre personave, qëllimi i tij është që të integrohen në shërbimet komunale, nëse edhe njëherë ka gabime, duhet të shtyhet për seancën tjetër.

Kadrije Lika Troni: Unë nuk e di a mundesh me më dhënë shifra kryetar, prandaj kisha kërkua që të shtyhet për seancën e ardhshme shkak se duhet të jetë edhe hartuesi këtu. Nenet nuk janë.
Kryesuesi i Kuvendit: Ky është afati i fundit me sa di unë për dorëzim. Nëse mundemi me e votua që ta kthejmë me rishqyrtim nëse ka gabim.

Kadrije Lika Troni: A mund të dimë shifra? Pse s'është e specifikuar.
Kryetari i Komunës: Ky është plan nuk është raport.

Ardita Rrahmani: Me të drejtë e ka për nenin, nëse e qesim në votim duhet ta hedhim me përmirësime në këto gabime të vogla, sepse plani është shumë mirë i formuluar që të ri integrohen e masat që do merren për këta persona që duan të ri integrohen në shoqëri.

Kadrije Lika Troni: Dokumenti po thotë që i referohet strategjisë për Migrim të vitit 2021-2025, kjo strategji a ndryshon? Apo ju kemi referua gabimisht.

Heset Malsiu: Mendoj që është pak telashe kjo puna që sponzori i kësaj çështje nuk është këtu sepse kisha deshtë shumë pyetje me bë.

Ernesta Krasniqi: Është pikëpyetje që nëse plani nuk është hartuar në bazë të atij neni që e vendosni? Se duhet të dimë a ka pasur ndonjë shkelje, nuk është zgjidhja me e qit në votim.

Ardita Rrahmani: Jemi duke diskutua që disa herë me këtë ndryshim, me gjetur nenin dhe me i dërgua, ka një organ më të lartë se ne që e kthen nëse nuk e dërgon mirë.

Kryesuesi i Kuvendit: Plani për ri integrim e shtroj në votim për me e tërheqë si pikë. Prezent ishin 20, 18 vota për dhe 2 Kundër, me këtë rast Kuvendi konstatoj se mori:

VENDIM PËR SHTYRJEN E SHQYRTIMIT TË PIKËS

Plani Komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Kaçanikut/Lënda: 01Nr. 561/02-20607/26.

Kalojmë në pikën vijuese

11. Propozim Vendim për Miratimin e raportit përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e breshërit;

E hapi diskutimin:

Kadrije Lika Troni: Ne jemi këtu me u ndihmuar, vetëm desha të interesohem se nga cili nivel u dalin mjetet.

Kryesuesi i Kuvendit: Nga niveli qendror. Diskutim tjetër nuk ka, atëherë këtë pikë e shtoj në votim për aprovim, u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Konstatoj se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit komunal nr. 08-320/02-18540/26 i datës 23.07.2026 -për kompensimin e dëmeve nga reshjet e breshërit të datës 21.07.2026 në fshatin Gajre, fermerit Sadik Qallaku/ Lënda: 01Nr. 104/02-24162/26.

Mbledhja i përfundoj në ora 15:05. Deri në fund të mbledhjes ishin 20 anëtarë.

Shënim: (Procesverbalin e përpiloi, Asistentja e Kryesuesit të KK, duke u bazuar në video incizimin e mbledhjes së tetë (VIII) të Kuvendit të Komunës të datës 29.09.2026 dhe të shënimeve të procesmbajtëses).

Përpiloi
Arianita Bajrami

Kryesues i Kuvendit
Selajdin Troni

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/ Municipality of Kaçanik
Zyra e Kryetarit

KAÇANIKU

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KACANIK

Data 20.10.26 Vendi KAÇANIK
Nr. Numri Shtojce
01 400/01-27763 /.

REFERENCË	
DATË	19.10.2026
PËR/ZA/TO:	Selajdin Troni - Kryesues i Kuvendit Komunal Zyra e Kuvendit Komunal Kaçanik
CC:	Arton Ahmeti - Sekretar i Përgjithshëm Ministria e Financave
PËRMES/PREKO/THROUGH	Valdrin Dogani - Drejtor për Buxhet dhe Financa Fitore Vishi - Zyrtare Kryesore Financiare Komuna e Kaçanikut
NGA/OD/FROM:	Sabedin Vishi - Zyrtar Kryesor Administrativ Kryetar i Komunës së Kaçanikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Raportit Nëntëmujor Financiar për periudhën 01.01.2026 – 30.09.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVA

I nderuar,

Në mbështetje të nenit 45, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, po ju dorëzojmë Raportin Nëntëmujor Financiar të Komunës së Kaçanikut për periudhën 01.01.2026 – 30.09.2026, me qëllim të shqyrtimit të tij nga Kuvendi Komunal.

Raporti i bashkangjitur përmban të dhënat lidhur me realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, investimet dhe detyrimet buxhetore, si dhe përmbledhjen e statusit të realizimit të projekteve kapitale gjatë nëntë muajve të vitit fiskal 2026, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Ju lutem që raporti të procedohet për shqyrtim në Kuvendin Komunal, ndërsa njëkohësisht një kopje e tij t'i përcillet edhe Ministrisë së Financave, në përmbushje të obligimeve ligjore për raportim financiar periodik.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK – MUNICIPALITY OF KAÇANIK

RAPORTI NËNTËMUJOR FINANCIAR

2026

Për periudhën 01 Janar 2026 – 30 Shtator 2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Kaçanik, Tetor 2026

I. Hyrje

Raporti Nëntëmujor Financiar për periudhën 01 janar 2026 – 30 shtator 2026 është përgatitur për të paraqitur në mënyrë të plotë, të kuptueshme dhe transparente ecurinë e realizimit të buxhetit të Komunës së Kaçanikut gjatë nëntëmujorit të vitit fiskal 2026.

Raporti përfshin realizimin e të hyrave vetanake, ekzekutimin e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike dhe programeve buxhetore, si dhe gjendjen e investimeve dhe projekteve kapitale. Të dhënat financiare janë marrë nga tabelat e raportit nëntëmujor të përgatitura mbi bazën e Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK).

II. Baza ligjore

Ky raport është përgatitur në pajtim me **Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë**, përkatësisht me **nenin 45**, sipas të cilit Kryetari i Komunës përgatit dhe i dorëzon Kuvendit Komunal raportet tremujore financiare, ndërsa një kopje i përcillet ministrisë përkatëse brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo tremujori.

III. Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është informimi i Kuvendit Komunal për nivelin e realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve gjatë periudhës janar–shtator 2026, krahasimin me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ecurinë sipas kategorive ekonomike dhe programeve buxhetore, si dhe faktorët që ndikojnë në ekzekutimin e investimeve kapitale.

IV. Organizimi i programeve buxhetore sipas drejtorive dhe zyrave

Për qëllime të paraqitjes së qartë të realizimit buxhetor, të hyrat dhe shpenzimet në këtë raport janë të organizuara sipas 19 programeve buxhetore që u përkasin drejtorive dhe zyrave përkatëse, si në vijim:

- Zyra e Kryetarit (16028 – Zyra e Kryetarit)
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme (16328 – Administrata)
- Zyra për Barazi Gjinore (16528 – Çështje Gjinore)
- Zyra e Kuvendit (16928 – Zyra e Kuvendit Komunal)
- Drejtoria e Buxhetit dhe Financave (17528 – Buxheti)
- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës (18028 – Shërbime Publike – Infrastruktura Rrugore dhe 18432 – Zjarrfikësit dhe Inspektimet)
- Zyra për Komunitete dhe Kthim (19640 – Zyra Lokale e Komuniteteve)
- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë (47028 – Bujqësia)
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit (48028 – Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik)
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (66445 – Planifikimi Urbanizmi Inspeksioni)
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (73037 – Administrata (Sh), 74700 – Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor dhe 75636 – Shërbimet Sociale)
- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (85028 – Shërbimet Kulturore)
- Drejtoria e Arsimit (92140 – Administrata (A), 92750 – Arsimi Parafillor / Çerdhet, 93810 – Arsimi Fillor dhe 95010 – Arsimi i Mesëm)

V. Përmbledhje ekzekutive

Deri më 30 shtator 2026, Komuna e Kaçanikut ka realizuar shpenzime në vlerë prej **9,903,021.84 €**, ose **71.57%** të buxhetit aktual prej 13,836,529.19 €. Në raport me periudhën janar–shtator 2025, shpenzimet janë më të larta për **78,883.73 €**, apo **0.80%**.

Nga granti qeveritar janë shpenzuar 9,423,971.32 €, ose 76.40% e buxhetit të këtij burimi. Granti specifik për arsimin parauniversitar ka realizuar 99.15%, granti specifik për shëndetësinë primare 76.02%, ndërsa granti i përgjithshëm 58.11%.

Të hyrat vetanake të inkasuara gjatë periudhës janar–shtator 2026 kanë arritur 800,229.99 €, ose 75.13% e planit vjetor prej 1,065,133.00 €. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, inkasimi është rritur për 116,928.70 €.

Të hyrat direkte përbëjnë 594,585.87 €, ndërsa të hyrat indirekte 205,644.12 €.

Tabela 1. Përmbledhje e raportimit - Periudha 01.01.2026 - 30.09.2026

Përshkrimi	Buxheti 2026 (€)	Buxheti aktual 2026 (€)	Shpenzimet Janar - Shtator 2026 (€)	Varianca ndaj buxhetit (€)= Buxheti aktual 2026- Shpenzimet Janar - Shtator 2026	Ekzekutimi (%)= Shpenzimet Janar - Shtator 2026/ Buxheti final 2026	Shpenzimet Janar - Shtator 2025 (€)	Dallimi Shpenzimet Janar - Shtator 2026/2025 (€)	Dallimi Shpenzimet Janar - Shtator 2026/2025 (%)
1. Granti i Përgjithshëm	5,886,269.00	5,886,269.00	3,420,311.82	2,465,957.18	58.11%	3,605,553.29	(185,241.47)	-5.14%
2. Granti specifik për Arsim parauniversitar	4,761,842.00	4,761,842.00	4,721,544.84	40,297.16	99.15%	4,273,596.96	447,947.88	10.48%
3. Granti specifik për Shëndetësi primare	1,686,509.00	1,686,509.00	1,282,114.66	404,394.34	76.02%	1,151,497.34	130,617.32	11.34%
I. Gjithsej GRANTI QEVERITAR (GQ= 1+2+3)	**12,334,620.00**	**12,334,620.00**	**9,423,971.32**	**2,910,648.68**	**76.40%**	**9,030,647.59**	**393,323.73**	**4.36%**
4. Të Hyrat Vetanake	1,065,133.00	1,065,133.00	236,063.70	829,069.30	22.16%	346,228.93	(110,165.23)	-31.82%
5. Të Hyrat Vetanake nga viti i kaluar	-	430,535.34	239,306.82	191,228.52	55.58%	411,555.43	(172,248.61)	-41.85%
II. Gjithsej TË HYRA VETANAKE (THV= 4+5)	**1,065,133.00**	**1,495,668.34**	**475,370.52**	**1,020,297.82**	**31.78%**	**757,784.36**	**(282,413.84)**	**-37.27%**
6. Participimet	-	3,840.85	3,680.00	160.85	95.81%	1,581.05	2,098.95	
7. Donacionet		2,400.00	-	2,400.00	0.00%	34,125.11	(34,125.11)	-100.00%
II. Gjithsej PARTICIPIME dhe DONACIONE (GPD= 6+7)	**-**	**6,240.85**	**3,680.00**	**2,560.85**	**58.97%**	**35,706.16**	**(32,026.16)**	**-89.69%**
Gjithsej (I+II+III)	**13,399,753.00**	**13,836,529.19**	**9,903,021.84**	**3,933,507.35**	**71.57%**	**9,824,138.11**	**78,883.73**	**0.80%**

Buxheti fillestar i miratuar për vitin 2026 është 13,399,753.00 €, prej të cilit 12,334,620.00 € janë grante qeveritare dhe 1,065,133.00 € të hyra vetanake të planifikuara.

Buxheti aktual përfshin edhe mjetet e bartura dhe burime të tjera të evidentuara gjatë vitit.

VI. Raporti mbi të hyrat

Në këtë kapitull paraqitet realizimi i të hyrave për periudhën **01 Janar 2026 – 30 Shtator 2026**, duke përfshirë të hyrat vetanake sipas të dhënave të evidentuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) dhe raportet përkatëse.

Planifikimi vjetor i të hyrave vetanake është 1,065,133.00 € , kurse deri më 30 shtator 2026 janë inkasuar 800,229.99 € të hyra vetanake, ose 75.13% e planit.

Të hyrat direkte prej 594,585.87 € përbëjnë 74.30% të inkasimit, kurse të hyrat indirekte prej 205,644.12 € përbëjnë 25.70%.

Tabela 2. Raporti i të hyrave vetanake - Periudha 01.01.2026 - 30.09.2026

Emërtimi i të hyrave vetanake	Planifikimi 2026 (€)	Realizimi Janar - Shtator 2026 (€)	Realizimi (%)	Realizimi Janar - Shtator 2025 (€)	Dallimi 2026/2025 (€)
Të Hyrat Vetanake (I+II)	**1,065,133.00**	**800,229.99**	**75.13%**	**683,301.29**	**116,928.70**
1. Tatimi në pronë - Gjithsej	**478,502.00**	**218,737.74**	**45.71%**	**224,356.28**	**(5,618.54)**
Tatimi në tokë (parcelat)	93,925.00	-	-	-	-
Tatimi në pronë (objektet)	384,577.00	218,737.74	56.88%	224,356.28	(5,618.54)
2. Taksat komunale - Gjithsej	**456,631.00**	**317,259.24**	**69.48%**	**227,696.96**	**89,562.28**
Licencat dhe lejet	20,000.00	85,899.30	429.50%	9,008.37	76,890.93
Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	24,000.00	35,360.20	147.33%	16,029.00	19,331.20
Taksat e pajisjeve motorike	71,000.00	71,570.00	100.80%	65,120.00	6,450.00
Lejet për ndërtesa	309,631.00	31,473.35	10.16%	48,793.14	(17,319.79)
Taksat tjera komunale	32,000.00	92,956.39	290.49%	88,746.45	4,209.94
3. Ngarkesat komunale - Gjithsej	**120,000.00**	**57,371.52**	**47.81%**	**53,643.74**	**3,727.78**
Ngarkesat rregullatore	10,000.00	1,053.00	10.53%	1,747.64	(694.64)
Të hyrat nga qiraja	15,000.00	7,763.02	51.75%	6,838.60	924.42
Bashkë-pagesat për arsim	40,000.00	36,024.50	90.06%	30,633.50	5,391.00
Bashkë-pagesat për shëndetësi	5,000.00	10,956.00	219.12%	11,984.00	(1,028.00)
Ngarkesat tjera komunale	50,000.00	1,575.00	3.15%	2,440.00	(865.00)
4. Të hyrat tjera - Gjithsej	**10,000.00**	**1,217.37**	**12.17%**	**8,085.89**	**(6,868.52)**
Të hyrat tjera	10,000.00	1,217.37	12.17%	8,085.89	(6,868.52)
I. Të Hyrat Direkte (1+2+3+4)	**1,065,133.00**	**594,585.87**	**55.82%**	**513,782.87**	**80,803.00**
5. Policia e Kosovës (gjobat në trafik)	-	158,841.00	-	156,852.00	1,989.00
6. Gjykatat (gjobat)	-	16,830.00	-	11,730.00	5,100.00
7. Agjencioni i Pyjeve (taksat)	-	29,973.12	-	936.42	29,036.70
II. Të Hyrat Indirekte (5+6+7)		**205,644.12**	**-**	**169,518.42**	**36,125.70**

Krahasimi me vitin paraprak tregon rritje veçanërisht te taksat komunale. Ndërkohë, te tatimi në pronë evidentohet një rënie e lehtë krahasuar me periudhën janar–shtator 2025. Të hyrat nga licencat dhe lejet kanë arritur 85,899.30 €, certifikatat dhe dokumentet zyrtare 35,360.20 €, ndërsa taksat e pajisjeve motorike 71,570.00 €.

VI.1 Të hyrat vetanake sipas programeve buxhetore

Për një pasqyrë më të qartë të realizimit të të hyrave vetanake, në vijim paraqitet shpërndarja e tyre sipas programeve buxhetore dhe drejtorive përkatëse.

Shpërndarja e të hyrave direkte sipas programeve buxhetore paraqitet në Tabelën 3.

Shuma e të hyrave direkte sipas kësaj tabele është 594,585.87 €, në përputhje me përmbledhjen sipas llojeve të të hyrave.

Tabela 3. Inkasimet sipas programeve buxhetore (SIMFK) - Periudha 01.01.2026 - 30.09.2026

Programi buxhetor	Kodi	Përshkrimi	Janar - Shtator 2026 (€)	Janar - Shtator 2025 (€)	Dallimi 2026/2025 (€)
16328 - Administrata			**35,360.20**	**21,792.00**	**13,568.20**
	50013	Taksa për certifikatë të lindjes	14,383.00	12,532.00	1,851.00
	50014	Taksa për certifikatë të kurorëzimit	1,833.00	1,466.00	367.00
	50015	Taksa për certifikatë të vdekjes	863.00	457.00	406.00
	50016	Taksa për certifikata të tjera	16,406.20	1,344.00	15,062.20
	50017	Taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme	99.00	100.00	(1.00)
	50025	Taksa për shtetësi	1,776.00	130.00	1,646.00
	50413	Shitja e pasurisë publike	-	5,763.00	(5,763.00)
17528 - Buxheti			**290,867.21**	**299,566.77**	**(8,699.56)**
	40110	Tatimi në pronë	218,737.74	224,356.28	(5,618.54)
	50001	Taksa për regjistrim të automjeteve	71,570.00	65,120.00	6,450.00
	50019	Taksa të tjera administrative	559.47	8,047.60	(7,488.13)
	61000	Të hyrat nga viti i kaluar	-	2,042.89	(2,042.89)
18028 - Shërbime Publike - Infrastruktura Rrugore			**16,103.26**	**20,902.63**	**(4,799.37)**
	50008	Taksa për parkim publik, kamping dhe rekreacion	12,569.00	15,177.99	(2,608.99)
	50019	Taksa të tjera administrative	725.00	1,513.00	(788.00)
	50104	Gjobat nga inspektorati	1,575.00	2,440.00	(865.00)
	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	1,053.00	1,747.64	(694.64)
	50407	Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	-	24.00	(24.00)
	61000	Të hyrat nga viti i kaluar	181.26	-	181.26
47028 - Bujqësia			**20,697.43**	**13,659.96**	**7,037.47**
	50012	Taksa për ndërrim të destinimit të pronës	16,922.07	11,282.76	5,639.31
	50019	Taksa të tjera administrative	3,775.36	2,097.20	1,678.16
	50424	Pranimet nga tarifat për vendimet gjyqësore/përmbarimore	-	280.00	(280.00)
48028 - Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik			**880.00**	**-**	**880.00**
	50029	Taksa për ushtrimin e veprimtarive afariste	880.00	-	880.00
66445 - Planifikimi Urbanizmi Inspekcioni			**173,945.16**	**105,090.81**	**68,854.35**
	50009	Taksa për leje ndërtimi	21,360.50	41,718.43	(20,357.93)
	50011	Taksa për ndërrim të pronarit të pronës	332.41	81.90	250.51
	50019	Taksa të tjera administrative	12,185.93	24,319.80	(12,133.87)
	50026	Taksa për legalizimin e objekteve	10,112.85	7,074.71	3,038.14
	50032	Taksa për certifikatë të pronësisë dhe kopje plani	33,120.15	7,834.00	25,286.15
	50045	Taksa për leje mjedisore	85,899.30	9,008.37	76,890.93
	50407	Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	-	360.00	(360.00)
	50408	Qiraja nga prona publike	7,763.02	6,454.60	1,308.42
	50460	Taksa për regjistrim të pengut	830.00	670.00	160.00
	50504	Matja e tokës në terren	2,341.00	7,569.00	(5,228.00)
74700 - Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor			**19,672.00**	**22,137.20**	**(2,465.20)**
	50019	Taksa të tjera administrative	2,246.00	5,068.20	(2,822.20)
	50024	Taksa për certifikatë mjekësore	6,470.00	5,085.00	1,385.00
	50409	Participimet	10,956.00	11,984.00	(1,028.00)
85028 - Shërbimet Kulturore			**1,036.11**	**-**	**1,036.11**
	61000	Të hyrat nga viti i kaluar	1,036.11	-	1,036.11
92140 - Administrata			**75.50**	**117.50**	**(42.00)**
	50409	Participimet	75.50	117.50	(42.00)
92750 - Arsimi Parafillor / Çerdhet			**35,949.00**	**30,516.00**	**5,433.00**
	50409	Participimet	35,949.00	30,516.00	5,433.00
		Të Hyrat Vetanake	**594,585.87**	**513,782.87**	**80,803.00**

VI.2 Tatimi në pronë

Nga tatimi në pronë janë inkasuar 218,737.74 €, ose 45.71% e planifikimit vjetor prej 478,502.00 €. Në krahasim me nëntëmujorin e vitit 2025, inkasimi është më i ulët për 5,618.54 €. Krahasuar me gjashtëmujorin, inkasimi ka shënuar përmirësim gjatë tremujorit të tretë. Plani për tatimin në tokë është paraqitur veçmas në tabelë, pa inkasim të evidentuar në zërin përkatës.

VII. Raporti mbi shpenzimet

Në këtë kapitull paraqitet realizimi i shpenzimeve të Komunës së Kaçanikut për periudhën 01 Janar 2026 - 30 Shtator 2026, sipas kategorive ekonomike dhe programeve buxhetore.

Shpenzimet e përgjithshme për periudhën janar–shtator 2026 janë 9,903,021.84 €, me realizim 71.57% të buxhetit aktual. Arsimi dhe shëndetësia mbajnë peshën kryesore të shpenzimeve për paga, ndërsa shërbimet publike, arsimi dhe programet e tjera realizojnë shpenzime operative dhe investime.

Tabela 4. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike - Periudha 01.01.2026 - 30.09.2026

Kodi dhe kategoria ekonomike	Buxheti 2026 (€)	Buxheti aktual 2026 (€)	Shpenzimet Janar - Shtator 2026 (€)	Shpenzimet Janar - Shtator 2025 (€)	Realizimi përballë Buxhetit aktual 2026 (€)	Buxheti aktual 2026 - Shpenzimet Janar - Shtator 2026 (€)	Dallimi Shpenzimet Janar - Shtator 2026/2025 (€)	Dallimi Shpenzimet Janar - Shtator 2026/2025 (%)
11 Paga dhe Shtesa	7,883,305.00	7,883,305.00	6,427,777.79	5,469,789.52	81.54%	1,455,527.21	957,988.27	17.51%
13 Mallra dhe Shërbime	1,469,980.00	1,574,662.04	1,037,334.09	916,787.37	65.88%	537,327.95	120,546.72	13.15%
14 Shpenzime komunale	225,000.00	279,808.58	195,124.83	156,381.26	69.74%	84,683.75	38,743.57	24.78%
20 Subvencione dhe Transfere	614,157.00	652,851.00	411,064.16	347,135.52	62.96%	241,786.84	63,928.64	18.42%
30 Investime kapitale / Pasuritë jofinanciare	3,207,311.00	3,445,902.57	1,831,720.97	2,934,044.44	53.16%	1,614,181.60	(1,102,323.47)	-37.57%
30 Rezerva	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	**13,399,753.00**	**13,836,529.19**	**9,903,021.84**	**9,824,138.11**	**71.57%**	**3,933,507.35**	**78,883.73**	**0.80%**

VII.1 Shpenzimet sipas programeve buxhetore

Shpenzimet sipas programeve buxhetore dhe drejtorive paraqiten në raportin nëntëmujor financiar, Tabela 6. Shpenzimet sipas programeve buxhetore - Periudha 01.01.2026 - 30.09.2026, ku mund të identifikohen realizimi sipas njësisë organizative, kategoria ekonomike dhe krahasimi i përgjithshëm me periudhën e njëjtë të vitit 2025.

Tabela 6. Shpenzimet sipas programeve buxhetore - Periudha 01.01.2026 - 30.09.2026

Nr.	Kodi dhe emri i programit buxhetor	Stafi	Paga dhe Shtesa (€)	Mallra dhe Shërbime (€)	Shpenzime komunale (€)	Subvencione dhe Transfere (€)	Investime kapitale (€)	Gjithsej Janar - Shtator 2026 (€)	Struktura (%)	Gjithsej Janar - Shtator 2025 (€)	Dallimi Janar - Shtator 2026/2025 (€)
1	16028 Zyra e Kryetarit	27	235,530.72	22,803.49	-	87,400.00	-	**345,734.21**	3.49%	252,251.61	93,482.60
2	16328 Administrata	24	162,443.50	98,112.98	27,701.75	-	120,000.00	**408,258.23**	4.12%	304,326.77	103,931.46
3	16528 Çështje Gjinore	1	10,519.48	-	-	-	-	**10,519.48**	0.11%	8,833.59	1,685.89
4	16928 Zyra e Kuvendit Komunal	21	183,036.11	1,543.30	-	-	-	**184,579.41**	1.86%	188,020.04	(3,440.63)
5	17528 Buxheti	11	76,503.62	8,500.24	-	-	111,906.14	**196,910.00**	1.99%	242,038.74	(45,128.74)
6	18028 Shërbime Publike - Infrastruktura Rrugore	10	57,633.74	322,655.55	78,885.07	46,775.00	332,112.30	**838,061.66**	8.46%	1,292,790.95	(454,729.29)
7	18432 Zjarrfikësit Inspektimet	18	134,376.34	2,592.63	829.27	-	-	**137,798.24**	1.39%	120,728.98	17,069.26
8	19640 Zyra Lokale e Komuniteteve	1	8,118.97	-	-	-	-	**8,118.97**	0.08%	2,412.17	5,706.80
9	47028 Bujqësia	4	38,486.99	470.70	-	18,399.99	34,020.22	**91,377.90**	0.92%	85,121.48	6,256.42
10	48028 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik	3	24,851.60	1,132.45	-	33,304.18	55,831.87	**115,120.10**	1.16%	164,442.38	(49,322.28)
11	66445 Planifikimi Urbanizmi Inspekcioni	13	106,500.74	75,534.44	-	-	697,359.05	**879,394.23**	8.88%	1,037,586.78	(158,192.55)
12	73037 Administrata (Sh)	3	27,215.87	200.00	-	-	-	**27,415.87**	0.28%	23,912.25	3,503.62
13	74700 Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor	123	1,053,469.31	158,019.80	23,791.47	-	66,604.97	**1,301,885.55**	13.15%	1,166,159.26	135,726.29
14	75636 Sherbimet Sociale	8	65,201.76	1,387.43	333.87	10,000.00	69,955.00	**146,878.06**	1.48%	55,987.93	90,890.13
15	85028 Shërbimet Kulturore	18	106,019.12	58,326.08	11,704.51	108,000.00	101,286.94	**385,336.65**	3.89%	393,985.39	(8,648.74)
16	92140 Administrata (A)	7	53,390.36	2,990.34	-	22,288.99	-	**78,669.69**	0.79%	67,883.60	10,786.09
17	92750 Arsimi Parafillor Çerdhet	27	165,289.76	14,241.09	6,003.80	-	-	**185,534.65**	1.87%	173,278.80	12,255.85
18	93810 Arsimi Fillor	404	3,132,519.36	199,439.61	33,539.62	26,415.00	213,281.49	**3,605,195.08**	36.40%	3,240,474.53	364,720.55
19	95010 Arsimi i Mesem	100	786,670.44	69,383.96	12,335.47	58,481.00	29,362.99	**956,233.86**	9.66%	1,003,902.86	(47,669.00)
	Gjithsej	**823**	**6,427,777.79**	**1,037,334.09**	**195,124.83**	**411,064.16**	**1,831,720.97**	**9,903,021.84**	**100.00%**	**9,824,138.11**	**78,883.73**
	Struktura në (%) sipas kategorive të shpenzimeve		64.91%	10.47%	1.97%	4.15%	18.50%	**100.00%**			

VII.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike

Në vijim paraqitet realizimi i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike.

Paga dhe Shtesa

Në kategorinë Paga dhe Shtesa janë shpenzuar 6,427,777.79 €, ose 81.54% e buxhetit të kategorisë. Krahasuar me periudhën janar–shtator 2025, shpenzimet janë rritur për 957,988.27 €, apo 17.51%. Në krahasim ndikon edhe niveli i pagave në vitin 2026 dhe ekzekutimi i pagës së trembëdhjetë në muajin mars 2026.

Mallra dhe shërbime

Kategoria e mallrave dhe shërbimeve përfshin shpenzimet operative të domosdoshme për funksionimin e drejtorive dhe ofrimin e shërbimeve komunale ndaj qytetarëve.

Tabela 7. Përmbledhja e shpenzimeve për Mallra dhe Shërbime - Janar - Shtator 2026

Kodi ekonomik / përshkrimi	16028 Zyra e Kryetarit	16328 Administrata	16928 Zyrat Kuvendit Komunal	17928 Buxheti	18028 Shërbime Publike - infrastruktura Rrugore	18412 Zjarrfikësit Inspektimet	47028 Bujqësia	48028 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik	65648 Planifikimi Urbanistik/Inspektimi	73037 Administrata Sh	74700 Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor	75636 Shërbimet Sociale	85028 Shërbimet Kulturore	92140 Administrata (A)	92750 Arsimi Paafilllor Çerdhet	93810 Arsimi Fillor	93810 Arsimi i Mesëm	Gjithsej 2026 (€)	Struktura (%)	Gjithsej 2025 (€)	Dallimi 2026/2025 (€)
13140 - transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	4,968.71	-	**4,968.71**	0.48%	1,225.00	3,743.71
13141 - para xhepi/mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,012.00	-	**1,012.00**	0.10%	-	1,012.00
13143 - shpenzimet e tjera për udhëtimet zyrtare jashtë vendit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	320.00	-	235.82	-	**555.82**	0.05%	840.00	(284.18)
13310 - interneti	-	-	-	-	-	-	-	-	370.16	-	-	-	-	-	-	-	-	**370.16**	0.04%	70.56	299.60
13320 - telefonia mobile	-	3,431.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**3,431.01**	0.33%	3,196.79	234.22
13330 - shërbimet postare	-	80.40	-	6,356.74	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**6,437.14**	0.62%	5,100.54	1,336.60
13410 - shërbimet e arsimit dhe trajnimit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**-**	0.00%	200.00	(200.00)
13430 - shërbimet e ndryshme shëndetësore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3,068.20	-	-	-	-	-	-	**3,068.20**	0.30%	1,750.60	1,317.60
13440 - shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale	7,549.30	7,722.00	1,287.00	-	-	-	-	-	-	-	-	-	600.00	-	-	-	-	**17,158.30**	1.65%	16,424.00	734.30
13445 - shërbimet e veçanta - konsulentë dhe kontraktorë individual	3,920.00	3,125.00	-	625.00	-	-	-	-	3,140.00	200.00	25,250.00	-	-	-	-	-	-	**36,260.00**	3.50%	19,750.00	16,510.00
13450 - shërbimet e shtypjes/ printimit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2,709.00	-	-	898.65	-	**3,607.65**	0.35%	-	3,607.65
13460 - shërbimet kontraktuese të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	999.00	-	-	1,785.00	12,610.00	**15,394.00**	1.48%	16,613.33	(1,219.33)
13470 - shërbimet teknike	-	-	-	-	100.00	-	-	-	10,387.54	-	-	-	995.00	171.10	-	-	-	**11,653.64**	1.12%	8,436.50	3,217.14
13471 - softuerët - licencat dhe mirëmbajtja e tyre	-	-	-	-	-	-	-	-	420.00	-	-	-	-	-	-	-	-	**420.00**	0.04%	-	420.00
13475 - sigurimi fizik i objekteve publike	-	23,831.10	-	-	-	-	-	-	-	-	22,781.20	-	38,172.60	-	-	5,695.30	5,845.30	**96,325.50**	9.29%	80,393.86	15,931.64
13480 - shpenzimet e anëtarësimit	4,157.40	-	-	-	-	-	-	990.00	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**5,147.40**	0.50%	6,001.35	(853.95)
13501 - mobiljet	979.99	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**979.99**	0.09%	3,967.97	(2,987.98)
13504 - pajisjet e tjera të teknol.informative dhe të komunikimit	990.00	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**990.00**	0.10%	3,490.00	(2,500.00)
13509 - pajisjet e tjera	-	9,180.00	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**9,180.00**	0.88%	13,764.00	(4,584.00)
13610 - furnizimet për zyrë	3,426.20	5,474.00	-	129.50	-	-	-	142.45	558.26	-	4,396.00	-	-	-	300.00	3,127.99	-	**17,554.40**	1.69%	7,228.49	10,325.91
13620 - furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	582.23	-	-	-	9,389.48	-	-	**9,971.71**	0.96%	7,327.89	2,643.82
13630 - furnizimet mjekësore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	17,491.08	-	-	-	-	-	-	**17,491.08**	1.69%	17,856.69	(365.61)
13640 - furnizimet e pastrimit	-	1,076.60	-	-	-	159.40	-	-	-	-	2,244.00	339.65	1,452.75	-	1,707.60	4,790.87	2,702.00	**14,472.87**	1.40%	11,491.30	2,981.57
13660 - akomodimi për mikpritje të delegacioneve të jashtme	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	569.60	-	-	-	**569.60**	0.05%	-	569.60
13720 - nafta për ngrohje qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**-**	0.00%	7,237.85	(7,237.85)
13760 - drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	92,752.50	26,819.99	**119,572.49**	11.53%	31,940.00	87,632.49
13780 - derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri	-	13,308.78	-	-	-	1,808.23	470.70	-	-	-	15,829.93	548.53	2,923.62	-	329.01	1,723.69	-	**36,942.49**	3.56%	26,829.05	10,113.44
13810 - avancë (paradhënia) për para të imëta	-	500.00	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**500.00**	0.05%	500.00	-
13950 - regjistrimi i automjeteve	-	300.00	-	-	-	120.00	-	-	-	-	175.00	75.00	170.00	-	-	-	-	**840.00**	0.08%	1,130.00	(290.00)
13951 - sigurimi i automjeteve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	233.10	224.25	-	-	-	-	-	**457.35**	0.04%	2,105.33	(1,647.98)
13954 - kontrollimi teknik i automjeteve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**-**	0.00%	150.00	(150.00)
14010 - mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	-	5,228.75	-	-	-	505.00	-	-	619.00	-	5,739.50	200.00	689.00	-	-	-	-	**12,981.25**	1.25%	12,934.10	47.15
14022 - mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste	-	7,857.40	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**7,857.40**	0.76%	-	7,857.40
14023 - mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	990.00	2,515.00	16,967.00	13,479.98	**33,951.98**	3.27%	11,108.00	22,843.98
14024 - mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	8,835.75	-	-	-	-	-	-	**8,835.75**	0.85%	5,128.92	3,706.83
14026 - mirëmbajtja e objekteve sportive	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	8,773.99	-	-	-	-	**8,773.99**	0.85%	999.00	7,774.99
14027 - mirëmbajtja e objekteve kulturore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	739.12	-	-	-	-	**739.12**	0.07%	-	739.12
14032 - mirëmbajtja e rrugëve lokale	-	-	-	-	224,968.43	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**224,968.43**	21.69%	326,998.98	(102,030.55)
14040 - mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe të komunikimit	-	6,610.17	-	-	-	-	-	-	-	-	10,000.00	-	-	-	-	3,500.00	-	**20,110.17**	1.94%	-	20,110.17
14050 - mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	10,227.00	-	-	-	-	-	-	**10,227.00**	0.99%	21,240.00	(11,013.00)
14060 - mirëmbajtja rutinore	-	-	-	-	68,098.14	-	-	-	60,039.48	-	-	-	-	-	-	-	-	**128,137.62**	12.35%	105,179.26	22,958.36
14130 - qiraja për pajisje	-	4,162.17	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	588.64	-	3,111.34	-	**7,862.15**	0.76%	2,961.37	4,900.78
14310 - kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	1,780.60	6,175.60	256.30	1,389.00	-	-	-	-	-	-	-	-	102.00	65.00	-	282.90	133.00	**10,184.40**	0.98%	7,730.00	2,454.40
14410 - vendimet gjyqësore	-	-	-	-	29,488.98	-	-	-	-	-	31,166.81	-	-	286.00	-	58,587.84	7,793.69	**127,323.32**	12.27%	127,445.34	(122.02)
14415 - pagesat për tarifa - vendimet gjyqësore/përmbarimore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**-**	0.00%	41.30	(41.30)
14450 - pagesat - gjobat ndërinstitucionale	-	50.00	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**50.00**	0.00%	-	50.00
Gjithsej (€)	**22,803.49**	**98,112.98**	**1,543.30**	**8,500.24**	**322,655.55**	**2,592.63**	**470.70**	**1,132.45**	**75,534.44**	**200.00**	**158,019.80**	**1,387.43**	**58,326.08**	**2,990.34**	**14,241.09**	**199,439.61**	**69,383.96**	**1,037,334.09**	**100.00%**	**916,787.37**	**120,546.72**
Struktura në (%) sipas programeve buxhetore	2.20%	9.46%	0.15%	0.82%	31.10%	0.25%	0.05%	0.11%	7.28%	0.02%	15.23%	0.13%	5.62%	0.29%	1.37%	19.23%	6.69%	**100.00%**			

Në kategorinë Mallra dhe Shërbime janë realizuar shpenzime prej 1,037,334.09 €, ose 65.88% të buxhetit aktual. Në krahasim me nëntëmujorin 2025, shpenzimet janë më të larta për 120,546.72 €, ose 13.15%. Kjo kategori përfshin furnizime, mirëmbajtje, shërbime kontraktuese dhe shpenzime të tjera operative sipas kodeve ekonomike në raportin e detajuar.

14032 – mirëmbajtja e rrugëve lokale / Këto mjete janë realizuar në kuadër të programit 18028 – Shërbime Publike – Infrastruktura Rrugore dhe lidhen me pagesat e kryera për tri lloj shërbimesh, përkatësisht: 1) mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale, në vlerë 160,655.46 € 2) mirëmbajtja e ndriçimit publik, në vlerë 39,246.55 € si dhe 3) rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal në Komunën e Kaçanikut, në vlerë 25,066.42 € . Këto shpenzime kanë ndikuar në ruajtjen e infrastrukturës rrugore dhe në sigurimin e qarkullimit më të rregullt dhe më të sigurt për qytetarët.

14060 – mirëmbajtja rutinore / Janë realizuar shpenzime në shumë prej 128,137.62 €. Prej tyre, 68,098.14 € janë realizuar në kuadër të programit 18028 – Shërbime Publike – Infrastruktura Rrugore, për mirëmbajtjen rutinore të hapësirave dhe infrastrukturës publike. Ndërsa shuma prej 60,039.48 € është realizuar në kuadër të programit 66445 – Urbanizëm, për kontratën "Mbyllja e deponive ilegale dhe rrënimi i objekteve pa leje".

14410 - vendimet gjyqësore / Janë realizuar shpenzime në vlerë prej 127,323.32 € për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore që rrjedhin nga kontratat kolektive në sektorin e arsimit. Këto shpenzime kanë ndikuar në buxhetin komunal, duke zvogëluar mjetet e disponueshme për realizimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të planifikuara.

13760 – drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje / Janë realizuar shpenzime në shumë totale prej 119,572.49 €, të shpërndara në programet 93810 - Arsimi Fillor (shuma 92,752.50 €) dhe 95010 - Arsimi i Mesëm (shuma 26,819.99 €). Këto shpenzime lidhen me sigurimin e lëndës djegëse për ngrohje në institucionet arsimore.

13475 – sigurimi fizik i objekteve publike / Janë realizuar shpenzime në shumë totale prej 96,325.50 €, të cilat lidhen me pagesat për sigurimin fizik të objekteve publike. Këto shpenzime janë evidentuar në disa programe buxhetore, përkatësisht në Administratë (objekti i Administratës), Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor (QKMF), Shërbimet Kulturore (Shtëpia e Kulturës "Xheladin Kurtaj" dhe Palestra e Sporteve) dhe në Arsimin Fillor dhe Arsimin e Mesëm (shkollat).

Në kategorinë Mallra dhe Shërbime përfshihen kryesisht furnizimet me derivate, materiale për zyrë, pajisje, ushqim dhe pije, shërbimet profesionale dhe kontraktuese, mirëmbajtja e objekteve, automjeteve dhe pajisjeve, shërbimet e teknologjisë informative, internetit dhe telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, përfaqësimit, si dhe shpenzime të tjera për funksionimin e institucioneve komunale.

Shpenzime komunale

Shpenzimet komunale përfshijnë pagesat që lidhen me shërbimet komunale dhe shpenzimet e domosdoshme për funksionimin institucional.

Tabela 8. Përmbledhja e shpenzimeve për Shpenzime komunale - Janar - Shtator 2026

Kodi ekonomik / përshkrimi	16328 Administrata	18028 Shërbime Publike - Infrastruktura Rrugore	18432 Zjarrfikësit Inspektimet	74700 Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor	75636 Sherbimet Sociale	85028 Shërbimet Kulturore	92750 Arsimi Parafillor Çerdhet	93810 Arsimi Fillor	95010 Arsimi i Mesem	Gjithsej 2026 (€)	Struktura (%)	Gjithsej 2025 (€)	Dallimi 2026/2025 (€)
13210 - energjia elektrike	20,274.22	78,828.62	578.27	19,186.07	243.03	8,794.14	2,393.98	21,142.89	4,838.70	**156,279.92**	80.09%	102,420.12	53,859.80
13220 - shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	779.69	56.45	58.94	1,751.81	-	1,640.29	25.05	3,726.81	1,934.66	**9,973.70**	5.11%	9,725.92	247.78
13230 - mbeturinat	5,564.16	-	-	2,056.32	-	1,270.08	3,507.84	7,620.48	4,838.40	**24,857.28**	12.74%	27,609.46	(2,752.18)
13250 - telefonia fikse	1,083.68	-	192.06	797.27	90.84	-	76.93	1,049.44	723.71	**4,013.93**	2.06%	3,531.44	482.49
13260 - pagesat - vendime gjyqësore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**-**	0.00%	13,094.32	(13,094.32)
Gjithsej (€)	**27,701.75**	**78,885.07**	**829.27**	**23,791.47**	**333.87**	**11,704.51**	**6,003.80**	**33,539.62**	**12,335.47**	**195,124.83**	**100.00%**	**156,381.26**	**38,743.57**
Struktura në (%) sipas programeve buxhetore	14.20%	40.43%	0.42%	12.19%	0.17%	6.00%	3.08%	17.19%	6.32%	**100.00%**			

Në kategorinë e shpenzimeve komunale janë realizuar 195,124.83 €, ose 69.74% e buxhetit aktual. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, shpenzimet janë rritur për 38,743.57 €, përkatësisht 24.78%.

Subvencione dhe transfere

Në kategorinë Subvencione dhe Transfere janë realizuar shpenzime prej 411,064.16 €, ose 62.96% e buxhetit aktual prej 652,851.00 €. Krahasuar me periudhën janar–shtator 2025, shpenzimet janë rritur për 63,928.64 €, ose 18.42%.

Shpërndarja e shpenzimeve sipas programeve buxhetore, kodeve ekonomike dhe detajeve tjera, është paraqitur në tabelat e bashkangjitura (Tabela 9 dhe Tabela 10).

Tabela 9. Përmbledhja e shpenzimeve për Subvencione dhe Transfere - Janar - Shtator 2026

Kodi ekonomik / përshkrimi	16328 Administrata	18028 Shërbime Publike - Infrastruktura Rrugore	18432 Zjarrfikësit Inspektimet	74700 Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor	75636 Sherbimet Sociale	85028 Shërbimet Kulturore	92750 Arsimi Parafillor Çerdhet	93810 Arsimi Fillor	95010 Arsimi i Mesem	Gjithsej 2026 (€)	Struktura (%)	Gjithsej 2025 (€)	Dallimi 2026/2025 (€)
21200 - subvencionet për entitetet jopublike	18,500.00	-	-	33,304.18	5,000.00	108,000.00	2,488.99	25,575.00	58,481.00	**251,349.17**	61.15%	256,560.53	(5,211.36)
22202 - transferet për përfitues individual tjerë	68,900.00	-	18,399.99	-	5,000.00	-	19,800.00	840.00	-	**112,939.99**	27.48%	46,499.99	66,440.00
22298 - pagesat për shërbimet e varrimit	-	46,775.00	-	-	-	-	-	-	-	**46,775.00**	11.38%	44,075.00	2,700.00
Gjithsej (€)	**87,400.00**	**46,775.00**	**18,399.99**	**33,304.18**	**10,000.00**	**108,000.00**	**22,288.99**	**26,415.00**	**58,481.00**	**411,064.16**	**100.00%**	**347,135.52**	**63,928.64**
Struktura në (%) sipas programeve buxhetore	21.26%	11.38%	4.48%	8.10%	2.43%	26.27%	5.42%	6.43%	14.23%	**100.00%**			

Gjatë periudhës janar – shtator 2026, janë realizuar shpenzime për mbështetjen financiare të përfituesve individualë, organizatave joqeveritare, bizneseve mikro dhe të vogla, bletarëve, klubeve sportive, shoqatave kulturore dhe artistike, si dhe organizatave që ofrojnë shërbime sociale. Gjithashtu, janë mbështetur nënat lehona, personat në gjendje të rëndë ekonomike dhe shëndetësore, studentët përmes bursave, transporti i nxënësve, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe shërbimet e varrimit.

Tabela 10. Detaje - Subvencione dhe Transfere - Periudha 01.01.2026 - 30.09.2026

Kodi/ Programi Buxhetor dhe Emri i Përfituesit	Gjithsej (€)
16028 ZYRA E KRYETARIT	**87,400.00**
QENDRA PER MBROJ. E GRAVE FEMIJVE SHTËPIA IME FERIZAJ	3,000.00
Organizata për Mbrojtjen e Mjedisit GJETHI	5,000.00
Org. e Veteran. të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Dega në Kaçanik	4,500.00
Organizata Komunale e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës-Kaçanik	1,000.00
SHKA GRYKA E KAÇANIKUT	5,000.00
Mbështetja e nënave lehona dhe ndihma momentale për persona me gjendje të rëndë ekonomike dhe gjendje të rëndë shëndetësore	68,900.00
18028 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE	**46,775.00**
Bashkësia Islame e Kosovës - Dega në Kaçanik / shërbimet e varrimit	46,775.00
47028 BUJQËSIA	**18,399.99**
AG-FERM SH.P.K. / Mbështetja e bletarëve me koshere bletësh dhe centrifugë elektrike, për nxjerrjen e mjaltit	18,399.99
48028 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	**33,304.18**
Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla (16 përfitues)	33,304.18
75636 SHERBIMET SOCIALE	**10,000.00**
SHPAK HK - HANDIKOS KAÇANIK	4,000.00
Organizata Komunale e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës-Kaçanik	1,000.00
Ndihma momentale për persona me gjendje të rëndë ekonomike dhe gjendje të rëndë shëndetësore	5,000.00
85028 SHËRBIMET KULTURORE	**108,000.00**
KF LEPENCI KAÇANIK	23,300.00
Shoq. e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor KAÇANIK	9,700.00
FONDACIONI BONEVET KAÇANIK	4,750.00
KLUBI I MUNDJES KAÇANIKU	5,120.00
KVK FEMRAT	6,000.00
KLUBI BASKETBOLLISTIK LEPENCI	3,450.00
MOTOKROSS KAÇANIKU	2,600.00
